

## NJOFTIM PUNËSIMI

<b>Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK</b>	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rogozhinë dhe Krujë.</p> <p>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për <b><u>një vend pune: Hidraulik pranë Mirëmbajtjes në Njësinë Operative Durrës</u></b>. Punëmarrësi i ri është përgjegjës për kryerjen e punimeve hidraulike sipas kushteve teknike dhe bazuar në urdhrat dhe instruksionet e Përgjegjës të Njësisë së Mirëmbajtjes.</p>
<b>Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zbaton brenda kritereve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga eprori dhe raporton për realizimin e tyre.</li><li>• Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi i Njësisë së Mirëmbajtjes dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.</li><li>• Zbaton në çdo kohë, sipas udhëzimeve të eprorëve rregullat dhe masat e sigurimit teknik në punë.</li><li>• Njofton Përgjegjësin e Njësisë së Mirëmbajtjes, për çdo problem që mund t’i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tij.</li><li>• Është në gatishmëri edhe pas kohës normale të punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence</li></ul>
<b>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Eksperienca pune të mëparshme.</li><li>• Librezë e Punës</li><li>• Certifikatë Familjare</li><li>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës</li><li>• Dy fotografi</li><li>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar</li><li>• Dëshmi Penaliteti</li><li>• Raporti Mjekësor</li><li>• Vërtetim Vendbanimi</li></ul>

**Kushtet e punës:**

- Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.
- Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.

- Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 02.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqtartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.